

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 02.06.2022	Numri i vrojtimit të lejes:	07 Nr.236/350-25856
------------------	-----------------------------	---------------------

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Edmond Elshani nga Suhareka, Komuna Suharekë, me 07 Nr.350-25856 të datës 29.04.2022 - në të cilën kërkon dhënie e lejes për vendosjen e ombrellave dhe tavolinave lëvizëse, gjeëjësisht shfrytëzimin e tokës shoqërore para lokalit të tij afarist, në bazë të nenit nenit 5, 14 dhe 21 të Ligjit të ndërtimit Nr. 04/L-110 dt. 31 Maj 2012, nenit 56 dhe 57 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve 01Nr.-16-423 dt. 26.01.2011, nenit 8 alinea 8.9 pika 8.9.1 të Rregullores për Tarifat , Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 , nenit 5 pika 5.2 al. 5.2.2 , nenit 6, 7, 8 pika 8.3 , nenit 9 al. 9.19.7 , nenit 11, 12, 13, 14, 15 dhe 17 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016 si dhe Procesverbalit 07Nr.189/350-25856 të datës 18.05.2022, nenit 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA -së bie këtë:

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Edmond Ibrahim Elshani	Nr. Personal	
Adresa:	“Edmond Elshani B.I.” (Simple Lounge Bar) Rr. “ Brigada-123 “- Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim - për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e tavolinave dhe ombrellave lëvizëse.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investueses - z. **Edmond Ibrahim Elshani** nga Suhareka, Komuna Suharekë, shfrytëzimi i hapsirës publike në një sipërfaqe prej **20.00m² (5.0x4.0)** - për vendosjen e tavolinave dhe ombrellave **lëvizëse** para lokalit të tij afarist “Simple Lounge Bar”, në parcelën kadastrale Nr.686-0, e cila evidentohet sipas fl. poseduese Nr. P-72116046-00686-0, zona kadastrale Suharekë, pronë shoqërore - vendi i quajtur “Fshat”, në rrugën “Brigada-123” përkatësisht sheshi “Ibrahim Rugova” në Suharekë.

Vendosja e tavolinave dhe ombrellave lëvizëse (ku për bazën e ombrellave nuk duhet të largohen gurët nga sheshi), si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore - hapsirës publike - **lejohet me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **18.05.2022** deri më **31.08.2022**, me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore.

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë hapsirën publike në një sipërfaqe prej **20.00 m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **18.05.2022** deri më **31.08.2022** është gjithsejtë : **207.16 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër dhe të mbjell lule (në mobilar urban).

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohet të kufizohet (rrethohet) .

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar .

Gjerësia e trotuarit për këtë pjesë të sheshit të jetë minimum 2.00m.(gjerësi e pastër) nga shtyllat e ndriçimit publik në drejtim të objektit afarist.

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës, ku lejohet shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të tavolinave dhe ombrellave lëvizëse, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e objekteve në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit .

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektet e cekura më lartë ti menjanoni për një kohë të caktuar.

Nëse ka ankesa nga ana e fqinjëve përshkak të zhurmës apo pengesave tjera të arsyeshme të banorëve për rreth, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Investuesi është i obliguar që më së paku 30 ditë para skadimit të afatit të këtij Pëlqimi të parashtroi kërkesë të re për zgjatjen e afatit për shfrytëzimin e hapsirës publike .

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj .

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse investuesi nuk i vendos këto brenda afatit të cituar në këtë Pëlqim.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investueses z. **Edmond Ibrahim Elshani** nga Suhareka, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohet shfrytëzimi i hapsirës publike në një sipërfaqe prej **20.00m² (5.0x4.0)** - për vendosjen e tavolinave dhe ombrellave lëvizëse para lokalit të tij afarist "Simple Lounge Bar", me afat të caktuar me këtë Pëlqim.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.


Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e Taksës Administrative - Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapsirës publike konform Rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës:
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

